



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 20 tetor 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Shpejtim Bulliqi, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DA.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKSB-së: z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe z.Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; znj.Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian dhe znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Bekim Karagjia dhe z. Ryan Scherba – OSCE; znj. Eshter Gula, përfaqësuese e KFOR-it; z.Alban Zeka, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit.

z. Avni Fetahu, përshëndetje për të gjithë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, më lejoni të ju informojë se në mungesë të Kryetarit të Komunës për shkak të të angazhimeve e hap mbledhjen e KKSB-së. Gjithashtu përshëndes dhe zyrtarin nga MPB /DSB z. Dargan Duraku, i cili është prezentë në këtë takim si dhe togëren znj. Valbona Blakçori, e cila është prezentë në zëvendësim të Komandantit të Stacionit të Policisë.

Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

Rendi i ditës u miratua njëzëri

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 15 gusht 2023

U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Avni Fetahu, fillimisht rreth kësaj pike fjalën ia kalojmë zëvendës komandantes së Stacionit të Policisë togeres znj. Valbona Blakçori.

znj. Valbona Blakçori, sikurse e theksoi kryesuesi i takimit, pasi që Komandanti i Stacionit Policor është në pushim vjetor, nga ana e tij jam autorizuar të bëjë prezantimin e situatës së sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor. Duke iu referuar procesverbalit të takimit të fundit sa i përket raportit të Policisë nga data 15 gusht 2023 kemi bërë një përmbledhje lidhur me situatën e sigurisë dhe rastet të cilat janë raportuar dhe trajtuar nga ana e zyrtarëve policor nga muaji 1 korrik deri më 30 shtator, por unë kam përfshi në raport edhe periudhën e muajit gusht sepse nuk ka qenë e përfshirë në kohën e raportimit të mëparshëm të bërë nga ana e Komandantit të Stacionit të Policisë. Gjatë kësaj periudhe kohore që përfshinë 3 mujorin e sezonit veror, muajin korrik gusht e shtator kemi pas jashtëzakonisht angazhime të shumta operative. Ky dyfishim i këtyre angazhimeve është bërë për shkak të ardhjes së diasporës në vendlindje si e natyrshme, ku si rrjedhojë shtohet edhe numri i rasteve dhe i thirrjeve për asistencë policore. Rastet e raportuara nuk kanë ndikuar në rendin kushtetues por që kanë pasur impakt të madh në trefishimin e angazhimeve operative në terren dhe në angazhimin shtesë të personelit policor të cilët i kemi angazhuar edhe pas orarit të rregullt të punës së tyre. Në periudhën e cekur policia e rendit në bashkëpunim, koordinim dhe në bashkëveprim me njësitet tjera të specializuara në fusha të ndryshme duke për fshirë edhe atë të komunikacionit ka ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që sezoni veror të kalojë pa incidente dhe shqetësim për diasporën por edhe për gjithë komunitetin në përgjithësi. Ndër rastet më të rëndësishme të cilat janë raportuar dhe trajtuar së bashku me mekanizmat tjerë ligjvënës e zbatuese të cilat janë cilësuar juridikisht sipas Kodit Penal të Kosovës kanë qenë raste të cilat do të prezantoj para jush në mënyrë statistikore dhe atë: 1 vrasje, 1 vetëvrasje, 33 kanosje, 3 raste të ngacmimit, 17 sulme, 26 lëndime të lehta trupore, 1 rast sulm seksual, 20 raste të dhunës në familje, 8 raste të narkotikëve, 24 raste të vjedhjeve, 22 raste të vjedhjeve të rënda, 1 vjedhje grabitqare, 3 raste të shantazhit, 6 raste shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, 29 raste posedim i paautorizuar i armëve, 15 raste përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm, 1 rast pengim i personit zyrtar, 2 raste të sulmeve ndaj personave zyrtar, 128 raste të aksidenteve në komunikacion ku prej tyre 19 janë me lëndime.

Sa i përket angazhimeve operative e taktike në terren janë hartuar dhe implementuar 66 plane operative, të cilat janë hartuar sipas situatave vlerësuese dhe analizuere në terren nga ana e hierarkisë komanduese, nga zyrtarët por edhe njësisë së inteligjencës, janë bërë 9 asistime gjykatës, 8 administratës përmbartimore, 51 Kuvendit komunal, 1312 PKA, 22 armë të sekuestruara, 146 municion të kalibrit të ndryshëm, 75 persona të arrestuar prej tyre 42 janë ndaluar në qendrën e ndalimit, 215 urdhëresa penale janë realizuar rreth personave të kërkuar me urdhëresë të gjykatës dhe janë shqiptuar 3017 gjoba sipas legjislacionit të trafikut rrugor. Janë zbuluar 249 raste të ndryshme, janë kontrolluar 20 shtëpi dhe 9 lokale ku janë sekuestruar dëshmi të ndryshme dhe atë 22 armë, 146 fishek,

84 gëzhoja, 12 thika, 9 dëshmi me narkotik, 2 para të falsifikuara, 2 shufra metalike dhe një sperey.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë zbuluar e identifikuar 12 grupe kriminale të involvuara në raste të ndryshme të cilët kanë bashkëpunuar dhe ndervepruar në mënyrë të organizuar e strukturuar në kryerjen e veprave të ndryshme penale dhe ndaj të gjithëve është ngrit kallëzim penal dhe janë në procedurë gjyqësore.

Këto ishin rastet dhe rezultatet në punë, natyrisht policia ka edhe sfidat e saj e që njëra ndër to ishte dhe vazhdon të jetë komunikacioni, kjo për shkak të numrit të madh të qytetarëve dhe automjeteve të shumta në komunikacion dhe aksidente që kanë ndodhur. Besoj se përmes mediave jeni informuar ku 2 qytetarë kanë humbur jetën në komunikacion, ne jemi ne zbatim të planit siguria në komunikacion ku në kuadër të këtij plani kemi lansuar fushata të ndryshme vetëdijësuese tek qytetarët që të kenë kujdes të shtuar në komunikacion. Fushatat janë realizuar përmes klerikëve, ku kemi kërkuar që tu bëjnë thirrje qytetarëve për kujdes, përmes anëtarëve të KLSP-ve në takimet që kemi mbajtur, madje tani me komunikacionin rrugor, ku me që jemi në këtë takim dhe shoh përfaqësues të shoqërive të ndryshme shfrytëzoj momentin apo hapësirën që të gjithë të kontribuojmë në sensibilizimin duke bërë thirrje te komuniteti për kujdes të shtuar në komunikacion.

Sa i përket rasteve të dhunës në familje të cilat janë shumë më të ndjeshme në shoqëri ku protagonist kryesor i viktimizimit është gjinia femërore, në bazë të analizave të rasteve të raportuara të kësaj kategorie në Polici shumica e këtyre viktimave riviktimizohen disa herë në familje për shkak të mos posedimit të pronës e cila pronë i mohohet nga familja si trashigimtare për faktin se i takon gjinisë femërore dhe kjo nuk ka të drejtë të kërkojë pronën që i takon me ligj duke mos u trajtuar barabartë me fëmijët e gjinisë mashkullore. Për të ngritur nivelin e vetëdijes dhe për të parandaluar rastet e dhunës e stigmatizimin e këtyre viktimave nga familja e shoqëria ne jemi në hartimin e projektit vetëdijësues për të drejtën e grave në trashëgimi e cila ju garantohet me ligj, projekt i cili do të lansohet në muajin dhjetor dhe do të jenë të përfshirë edhe mekanizma e tjera kontributdhënëve në nivel lokal e qendror. Sa për informimin e juaj me fillimin e viti shkollor kemi aktivizuar planin operativ me zyrtar me rroba civile të cilët kanë për qëllim krijimin e rendit dhe sigurisë në shkolla. Besoj se jeni të informuar për rastin e arrestimit të një të mituri i moshës 16 vjeçare në qytetin e Pejës i cili kishte planifikuar një sulm terrorist në shkollën e tij dhe e gjithë kjo kishte ardhur si pasojë e vazhdueshme e bullizmit nga ana e bashkëmoshatarëve të tij. Me qëllim që të mos të kemi bullizim në shkolla dhe delikuencë të të miturve nëpër shkolla ne kemi filluar me ligjërata sikurse jeni informuar edhe ju Drejtor. Ligjëratat do të vazhdojnë gjatë periudhës 2023 -2024, mirëpo aktualisht jemi duke mbajtur ligjërata për komunikacion me temën “ Kthimi i sigurt në komunikacion. Jemi duke mbajtur ligjërata për delikuencën e të miturve, do të mbajmë për bullizmin dhe aktualisht jemi duke mbajtur me temën të miturit që bien ndesh me ligjin sepse shumë nga të miturit kryejnë vepra penale me bindjen apo u ka thënë ndokush se si i mitur nëse e kryen këtë ose atë vepër nuk do të kesh përgjegjësi penale, kështu që e kemi pa të arsyeshme që pavarësisht veprimeve dhe dukurive kriminale që ata mendojnë se nuk kanë përgjegjësi penale të informohen se kanë përgjegjësi penale dhe Policia dhe ligji do të merret me ta. Ju veç se i keni parë informatat për ngjarjet e fundit në veriun e vendit ku në detyrë është vrarë një zyrtar policor dhe është plagosur një tjetër ku karshi këtyre rasteve kemi ngritë nivelin e sigurisë dhe gatishmërisë. Përmes këtij takimi unë ftoj qytetarët të bashkëpunojnë me Policinë, të raportojnë për çfarëdo informate apo situatë të krijuar e të dyshuar që ata vet e perceptojnë. Ne jemi në patrullim të

vazhdueshëm rreth fshatrave që gjenden në zonën afër kufirit, ku kemi kontakte të vazhdueshme edhe me qytetarë. Me KFOR-in jemi në bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimeve. Po ashtu i sigurojmë qytetarët se edhe nëse nuk shihet prezenca me uniformë e Policisë në kemi angazhuar polic me rroba civile me automjete civile, kështu që nuk ka nevojë të krijohet panik dhe nuk ka vend për shqetësim, sepse ne jemi të angazhuar në këtë drejtim vazhdimisht. Së fundmi për njoftimin e juaj jemi pajisë edhe me armë të gjata dhe kemi vazhduar patrullimet me armë të gjata. Kemi zyrtarë në nivel të Stacionit të cilët kanë të kryer trajnimet e specializuara për përdorimin e këtyre armëve, kështu që nuk ka hapësirë për brengosje apo për shqetësim.

Përfaqësuesja e KFOR-it znj. Eshter Gula, theksoi, sa i përket KFOR-it, gjendjen e sigurisë publike e vlerësojmë të qetë dhe stabile. Bëjmë patrullime përgjatë vijës kufitare dhe gjithashtu kemi përfundime diku me 137 pjesëtarë nga kontingjenti rumun ju kanë bashkëngjitur KFOR-it dhe trupa nga Britania e Madhe. Trupat britanike të KFOR-it kanë filluar me patrullime në qytet dhe përgjatë vijës kufitare. Unë falënderoj institucionet e Komunës për bashkëpunimin, po ashtu edhe popullatën që jeton përgjatë vijës kufitare.

Përfaqësuesi i FSK-së rreshter Nexhip Jaha, theksoi, jam në zëvendësim të znj. Ilirianë Bunjaku sa i përket çështjes së sigurisë, e vlerësojmë të qetë dhe stabile. Ne vazhdimisht bashkëpunojmë me autoritetet lokale për çështjet me interes të përgjithshëm dhe për të mirën e qytetarëve.

z. Avni Fetahu, theksoi a ka dikush ndonjë çështje lidhur me këtë pikë, nëse jo kalojmë në pikën e radhës

3. Informatë për Planin e Reagimit Emergjent

z. Avni Fetahu, fillimisht fjalën e ka z. Bahri Selimi, Drejtor i DSHPMSH.

z. Bahri Selimi, theksoi, draft Plani i Reagimit Emergjent ka një rëndësi të jashtëzakonshme për të mos thënë të domosdoshme i cili ofron reagimin ndaj emergjencave dhe fatkeqësive me qëllim të shpëtimit të jetëve, mbrojtjes së shëndetit publik dhe të mirave materiale dhe restaurimit të shërbimeve esenciale dhe për të mundësuar në rimëkëmbjen ekonomike. Duke u bazuar në rëndësinë e madhe që ka ky plan, ne si Drejtori kemi ndjekë të gjitha procedurat në funksion të miratimit të Planit të Reagimit Emergjent në bashkëpunim me UNDP-në, AME-në dhe Kryqin e Kuq, kemi organizuar katër takime në të cilat ka qenë i përfshirë edhe një komision nga të gjitha Drejtoritë e Komunës dhe të fushave të sigurisë e që numri më i madh i tyre kanë qenë zyrtar për emergjenca. Prej këtyre katër takimeve ku kanë marrë pjesë ekspert të UNDP-së, AME-së, ne kemi ardhur te një draft plan të cilin në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës e kemi vu në shqyrtim publik, ku brenda periudhës së shqyrtimit presim që të gjithë të interesuarit të japin kontributin. Diskutimi publik do të zgjasë një muaj dhe atë nga data 04.10.2023 deri më 03.11.2023, ndërsa ditën e dëgjimit publik do ta mbajmë më 31.10.2023, ku do të shpaloset draft Plani dhe presim propozimet sugjerimet eventuale nga qytetarët dhe subjektet e interesuara. Arsyeja që e kemi si pikë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të KKSB-së është sepse ndërlihet me këtë draft Plan dhe si KKSB besoj se ka mjaft për të dhënë në funksion të pasurimit sa më shumë të këtij dokumenti, në mënyrë që kur të miratohet në Kuvendin e Komunës të dal sa më gjithëpërfshirës. Pra qëllimi ishte që të ju ofrohet juve si anëtarë të KKSB-së për të kontribuar në aspektin profesional. Përveç ditës së dëgjimit publik ju keni mundësi që nëpërmes emailit të zyrtarit të caktuar ti përcillni të gjitha kërkesat e juaja propozimet apo sugjerimet lidhur me këtë draft, po qese ndokush nga ju nuk ka mundësi të merr

pjesë në dëgjimin publik më 3.10.2023. Në këtë kontekst i kemi përfillë të gjitha procedurat ligjore. Nëse materialin nuk e keni në email, i njëjti do ju përcjellët, me ç'rast do të keni mundësinë që krejt sugjerimet e juaja mund t'i dërgoni përmes e-mailit dhe ato që vlerësohen të pranueshme do të inkorporohen në dokumentin e Planit. Është paraparë që në fund të muajit nëntor do të procedohet në Kuvend për miratim. E përsëris se koha e dëgjimit publik është e hapur kështu që keni mundësi të paraqitni propozimet apo vërejtjet e juaja.

z. Avni Fetahu, theksoi, e hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

z. Shemsi Jashari, theksoi kur flasim për çështjet që ndërlidhen me mbledhjet e kaluara, ka qenë një kërkesë e vazhdueshme që këto mbledhje të transmetohen drejtpërdrejtë, por nuk ka ndodhë. Po kërkoj një përgjigje pse nuk mund të transmetohen këto mbledhje. Kërkoj të kem një përgjigje me shkrim ku thuhet se nuk duam të bëjmë transmetimin e mbledhjeve, ose për të gjetur arsyetimin ligjor pse nuk transmetohen. Në këto mbledhje është krijuar një praktikë se nuk dorëzohet materiali i pikave të rendit të ditës. Mendoj që ky draft pavarësisht se është i publikuar ka qenë dashtë të jetë në e mailin tona bashkë me thirrjen e mbledhjes, përkatësisht me materialin që ka për tu diskutuar. Jo të gjithë e përcjellin ueb faqen e Komunës se çfarë po ndodhë dhe kur po i publikojnë dokumentet dhe a po i publikojnë. Drafti ka shumë nevojë për plotësim, por në rend të parë është mirë që pas një presioni thuajse një vit e gjysmë ka hy në rend dite që ky komision të merret me këtë punë. Është pozitive dhe besoj se gjatë rrugës po besoj se do të japim komentet tona. Kur të na dërgohet ky material, nëse na dërgohet në email kisha kërkuar që të na dërgoni versionin në word për shkak të ndërhyrjeve që mund të bëjmë, për të pasur mundësi të dhënies së komenteve dhe propozimeve në tekst. Diçka tjetër, drafti që unë e kam siguruar nuk e ka ekipin i cila është e angazhuar për të punuar. Mendoj që ne duhet të kemi emrat e atyre ekspertëve të angazhuar për përpilimin e draftit. Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit mendoj se ky dokument duhet të jetë sa më i kompletuar me sa më shumë të dhëna në mënyrë që institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij plani në rast nevojë ta kenë të qartë për veprimet që duhet ndërmarrë. Mendoj si Këshilli e kemi mundësinë këtu për të dhënë atë që kemi për të dhënë, sepse dëgjimet publike i kemi parë, fjala vjen për projektbuxhetin e Komunës, ku kanë dështuar dy takime që kanë qenë të organizuara në qytet. Përveç një takimi që është mbajtur në Orllan, dmth janë mbajtur takime me nga 3-4 persona. Pra si anëtarë të këtij Këshilli është dashur të kemi dokumentin për të dhënë kontributin tonë në vijë zyrtare për çka jemi të thirrur dhe kemi marrë përgjegjësi. Është mirë që mbahet dëgjimi publik por nuk pres që prej këtij dëgjimi publik të ketë mundësi për të kontribuar aq sa duhet në këtë dokument. Është mirë që filluat të bëhet ky dokument por uroj që të kryhet në formën më të mirë të mundshme për shkak se Komuna ka pas nevojë kaheerë për këtë dokument.

z. Bahri Selimi, theksoi, mendoj se debati është i frytshëm për të nxjerrë diçka më mirë në këtë draft plan. Nuk mund të thuhet se inicimi për përgatitjen e këtij plani është bërë për shkak të një presioni, sepse procedurat për hartimin e dokumentit kanë filluar më herët në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave –AME dhe UNDP-në, e që këtë e kam theksuar më herët. Ky draft plan nuk ka filluar vetëm për Komunën e Podujevës, por është i njëjti për të gjitha komunat, prandaj ne s'kemi pasur mundësi të bëjmë hapa më të shpejtë. Pra të gjitha komunat e kanë një draft plan i cili është përgatitë nga AME në bashkëpunim me UNDP-në dhe organizatën Kryqin e Kuq t/ë cilët edhe janë akterët kryesor në përgatitjen e këtij drafti, në bashkëpunim me komunat ku secila komunë ka mbajtur takime përmes komisioneve të formuara. Pra dokumenti ka qenë në procedurë të përgatitjes dhe ne nuk kemi pas mundësi të përshejtimit të atyre

procedurave. Kemi qenë në vazhdimësi në koordinim dhe bashkëpunim me ta. Sa i përket asaj që draft plani të dërgohet në formatin Word për të pasur mundësi për ndërhyrje me vërejtje dhe sygjerime, duhet ta kemi të qartë se ne nuk mund të ndërhyjmë në draft në atë formë. Dëgjimi publik bëhet që të paraqiten propozimet apo sugjerimet e secilit që ka interesim. Sugjerimet bëhen në formën me shkrim apo verbalisht gjatë dëgjimit publik, ku në procesverbal evidentohet secili propozim, sugjerim apo vërejtje dhe inkuadrimin e propozimeve, vërejtjeve apo sugjerimeve prapë e bën komisioni komunal në bashkëpunim dhe AME-në, sepse nuk kemi mundësi çka do apo çfarëdo propozimi të futet në dokument. Prandaj nuk është e rëndësishme se dokumenti a është në formatin PDF apo Word, sepse edhe në formatin PDF është e mundur të jepen propozime apo sugjerime, sepse ato vinë në formë të shkruar ku pastaj mblidhet komisioni dhe në afatin kohor ligjor i inkuadron në draft plan, nëse janë të pranueshme në aspektin ligjor dhe si rrjedhojë prapë procedohet në Kuvend ku edhe anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë të japin sugjerimet dhe ky votohet me ose pa sugjerimet e tyre. Sa i përket dëgjimeve publike ne i përmbahemi rregullativës ligjore dhe afateve të parapara dhe mund të inkuadrohet rreth dokumentit kushdo që ka interesim në ato dëgjime publike. Njoftimet për dëgjime publike bëhen përmes uebfaqes por edhe përmes mediave, por lidhur me dokumentin në fjalë nuk jam në gjendje të dijë se sa do të jetë numri i pjesëmarrësve në atë takim. Një prej metodave të informimit është edhe kjo që e kemi proceduar në Këshill dhe pse nuk ka qenë e domosdoshme edhe obliguese, ne këtu mund të japim mendimin tonë profesional. Ne mundemi të mbajmë dëgjim publik vetëm me përbërjen e KKS-së, përveç takimit të caktuar me qytetarë dhe unë në këtë aspekt jam në dispozicion që kjo të realizohet dhe ta paraqes para secilit që ka interesim, sepse interesi jonë i përbashkët është që të dal sa më profesional plani.

z. Shemsi Jashari, theksoi, nga asnjë nga këtu këtu nuk shoh se kanë interesim për të ju vendosur keq politikisht. Sikurse tha parafolësi se mendimet e juaja duhet proceduar por s'janë aq të rëndësishme. Me këtë na thua se për këtë vendos Kuvendi dhe se bën për ta lexuar dokumentin në formatin pdf. S'ka problem, e lexojmë në formatin pdf, por ideja është a doni punë dhe kontribut apo veç formalitet, e që si po shihet ky është veç një formalitet. Po mendoj se për të gjitha dokumentet tjera që mund të ndërlidhen me vota, kjo nuk është dashur të kalkulohet në votë sepse ka të bëjë me siguri. Unë e kam një të kaluar me strukturat e sigurisë, pra kam një përvojë dhe e di çka jam duke folur dhe e kam fjalën për t'i lehtësuar punën një anëtarit të këtij Këshilli, për qasje në atë dokument për të dhënë komentet, për të lënë gjurmë se ku duhet prekur në dokument. Ky është një draft dokument dhe nuk dmth se dikush sikurse e dërgon propozimin ashtu edhe miratohet. Sikurse jeni në dijeni është një rregullore për konsultime publike e cila obligon për të dhënë përgjigje cili koment është pranuar, cili nuk është pranuar dhe pse nuk është pranuar. Njëra prej arsyeve që qytetarët nuk vinë në dëgjime publike dhe që nuk japin komentet është pikërisht kjo që e përmenda, që janë të injoruar, sikur të thuhet ju folni sa të doni ne prapë e kryejmë punën tonë. Ju e kryeni punën e juaj sepse kenë numrat, nuk është problem por trajtimi ndaj neve që po na bëhet mendoj se e zbehë rëndësinë duke përfshirë edhe të pjesëmarrjes në këtë këshill fare, nuk di cili është motivi për të ardhur, përderisa në një fjalim prej tre minutash tri herë na the që ju mundeni me thanë por na prapë vendosim. E përsëris sepse është pjesë e procesverbalit që është realizuar, unë është dashtë të bëjë kërkesë dy herë në Komunë, ndërsa Agjencia për Informacion dhe Privatësi i ka obliguar për kthim të përgjigjes për qasje të dokumentit, kjo është keq. Kryetari i Komunës Shpejtim Bulliqi, në mbledhje të Këshillit në këtë sallë, në këtë përbërje tha se mua më është thënë se ka dokument, ndërsa po vërtetohet se nuk ka. Nuk është pjesë e

procesverbalit, nuk e di pse nuk e keni përfshirë, nuk është mirë me redaktua, por është dashur me reflektua. Për çdo mbledhje e ka si kërkesë për të iniciuar përgatitjen e Planit të Reagimit Emergjent, sepse komunat tjera që moti e kanë këtë dokument. Agjencia e Emergjencave është aktivizuar sepse e ka parë 80 % të Komunave nuk e kanë këtë dokument, kështu që u detyruan për ta kryer këtë punë, që në fakt ju duhet ta bëni. Fjala vjen merreni Komunën e Kaqanikut, Komunën e Pejës i kanë këto dokumente dhe i kanë përtërirë, pra ju e keni këtë përgjegjësi edhe si Komunë edhe si zyrtar përkatës. Por sido që të jetë me rëndësi është të bëhet ky dokument, por duhet ndërruar qasjen, sepse nuk ua merr askush kreditin për këtë dokument, po mendoj se secili prej këtyre që përfaqësojnë KFOR-in, Policinë e Kosovës edhe FSK-në kanë çka japin për këtë dokument, por nuk besoj se kanë vullnet për të dhënë diçka kur thua që ne e bëjmë, dhe nuk tregove se kush është pjesë e këtij grupi punues që punon në këtë dokument, sepse UNDP si organizatë është e madhe, po ashtu Agjencia e Emergjencave është e madhe, pra cilët janë me emra konkret pjesë e këtij grupi punues, mendoj se është e rëndësishme që të jemi në dijeni, pra kush e udhëheq këtë grup.

z. Bahri Selimi, theksoi, parafolësi këtë e bëri çështje politike, por askush nuk e përmendi këtu politiken edhe pse Komuna bën politikë por nuk u përmend asnjëherë në këtë rast. Sa i përket këtij draft Plani edhe njëherë e theksoj se asnjë qytetar në Komunën tonë nuk përjashtohet të jap kontributin e vet këtu. Unë i tregova procedurat si janë zhvilluar dhe si do të zhvillohen pastaj, se a vjen dokumenti në formatet Word apo PDF është problemi më i vogël, sepse unë tash i them sekretarisë për tua dërgua draftin në formatin në word. Unë i tregova parafolësit se çka mund të bëjmë ne si komision në raport me këtë plan dhe theksova se marrim sugjerime dhe mendime dhe nuk thash se i marrim mendimet e tua vetëm ashtu, por ju e thatë. E përsëris i marrim sugjerimet jo vetëm nga ty edhe të një organi që është shumë i rëndësishëm për sigurinë e Komunës por prej secilit qytetar pa dallim, duke e vlerësuar nëse sugjerimi vlen të merret dhe inkorporohet në dokument. Shtrohet pyetja kush e vlerëson se a duhet apo jo të merret parasysh sugjerimi, këtë e vlerëson Komisioni përkatës dhe ajo përbërje ka punuar, por që nuk po mundem të flas për emra sepse nuk i njoh me emra anëtarët e komisionit nga UNDP dhe AME-së të cilët kanë punuar, por mund ti sjell emrat. Unë nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit kam qenë përgjegjës për të ngritur një komision dhe e kemi dërguar atë komision të cilin e ka udhëheq një zyrtar komunal për emergjenca dhe së bashku me akterët e angazhuar kanë sjellë këtë draft. Komisioni me akterët tjerë kanë organizuar workshop dhe e kanë përpiluar këtë draft bashkërisht. Unë në këtë rast jam përgjegjës sepse jam drejtor i Drejtorisë, por nuk jam kompetent sepse nuk e marr përgjegjësinë në raport me ata që kanë mbajtur katër ditë workshop, pra nuk e marr atë përgjegjësi sepse është e tyre. E përsëri sugjerimet dhe komentet i merr komisioni i cili i vlerëson për inkorporim apo jo në draft dokumentin.

z. Shemi Jashari, theksoi, jemi në dijeni si fjala vjen FSK si strukturë e specializuar dhe emergjenca kanë marrë pjesë në shumë misione pikërisht të kësaj natyre që e mbulon këtë plan emergjent, andaj është e rëndësishme ekspertiza e tyre, për të qenë e pjesë e atij komisioni për përgatitjen e planit. Kam pas rast të takohem me përfaqësues prej KFOR-it që kanë qenë të gatshëm për të ofruar ekspertizë që kanë përvojë 2-3 dekada në fushën e ekspertizës, shtrohet pyetje pse nuk kërkohen për të qenë pjesë e atij Komisioni, janë pa pagesë, pa kosto financiare. Më befason se si përgjegjës për emergjenca në Komunën e Podujevës, është ngritë një komision që e harton një dokument kaq të rëndësishëm, por

nuk i ke emrat, nuk ka ndonjë dokument publik që e tregon komisionin. Kjo nuk është trupë sekrete sepse nuk po bëhen plane sekrete, është një dokument.

z. Bahri Selimi, theksoi, AME-në e përmenda pesë herë këtu e cila ka iniciuar procedurat dhe të gjithë akterët e jashtëm, dhe e njëjta ka kërkuar të ngritim edhe komisionin komunal, kështu që AME ka pas përgjegjësinë të ftoj edhe përfaqësues të FSK-së dhe të KFOR-it në cilësinë e ekspertëve sepse ne nuk e kemi atë kompetencë t'i përfshijmë në komision, përfshirë edhe atë nga Stacioni i Policisë sepse nuk është përgjegjësi e jona, ne kemi kompetenca vetëm brenda Administratës komunale. Këto çështje i ka pas AME bashkë me UNDP-në. Unë do ti sjell emrat se kush ka marr pjesë në përgatitjen e draftit por për momentin nuk i kam sepse nuk jam në dijeni se kush është. Duhet kuptuar përgjegjësitë sepse nuk mund të përfshijë pjesëtarë të FSK-së, ose të Policisë në komision të Komunës.

z. Avni Fetahu, theksoi, falënderojmë Drejtorin për sqarimet dhe diskutimet e bëra. Dua të theksoj diçka nga përvoja, për çdo dokument zyrtar është i obliguar komisioni të sqaroj se ato komente dhe sugjerime kanë bazë ligjore dhe mund të inkorporohen në dokument, ndërsa ato të cilat nuk kanë bazë ligjore nuk inkorporohen. Inkurajoj edhe komisionin dhe të gjithë që të ofrojnë mundësinë sa më të lehtë të mundshme në mënyrë që të kontribuojë secili në një dokument të rëndësishëm për Komunën tonë. Nënvizoi, që këto mbledhje që nga viti i kaluar dhe këtë vit kam qenë prezentë çdo herë dhe e vërteta është se ne kemi pas mungesë të dokumenteve, ku disa zyrtar as kompjuterët nuk i kemi gjetur në Komunë, pra mund të ketë që ka mungesë të dokumenteve mirëpo, sikurse u tha që ka thënë kryetari më kanë tregua drejtë, unë nuk e di që ka thënë, sigurisht se kam dëgjua, ka mundur me thanë që ka munguar ky dokument, përndryshe ne presim kontributin e juaj. Nëse nuk ka dikush tjetër diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë nga SHZSH për intervenimet dhe gatishmërinë në rastet kundër zjarreve dhe intervenimet tjera

z. Avni Fetahu, fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z. Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, theksoi kam sjellë këtë informatë lidhur me intervenimet e Shërbimit të Zjarrfikësve që përfshinë periudhën kohore prej 01 janar deri më 15 tetor të këtij viti, me qëllim të njoftimit për intervenimet e bëra por edhe të gjendjes aktuale të Shërbimit të Zjarrfikësve, ku pajtohem dhe jam i sigurt që nuk është e mirë. Njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit është shërbim emergjent i cili paraqet një segment të rëndësishëm në aspektin e sigurisë së qytetarëve. Shërbimi ka në përbërje të stafit 14 zjarrfikës, zyrtarin për parandalim dhe komandantin, pra shihet si strukturë shumë e mangët në Komunë ku në bazë të numrit të banorëve duhet të kishim 49 zjarrfikës, sikurse që parashihet me proporcion 1 zjarrfikës në 1500 banorë. Pra si rezultat i numrit të vogël të stafit kjo njësi është duke qëndruar me shumë vështirësi. Kjo funksion 24 pa ndërprerë me 4 shërbime, me dy ndërrime nga 3 zjarrfikës dhe me 2 ndërrime nga 4 zjarrfikës, ku edhe këtu shihet se ka mangësi të ekipeve për dalje në terren. Pra sipas rregullores përkatëse të tyre nuk ka ekip që duhet të dalë në terren me 3 zjarrfikës, por në ekip të përbashkët prej 5 zjarrfikës e më shumë, por në mungesë të stafit prapë e shohim dhe veprojmë në ato forma si na jepet mundësia. Në vijim ju prezantoj numrin e përgjithshëm të daljeve për periudhën e cekur ku është intervenuar në 574 raste, ndërsa në vitin 2022 po të njëjtën periudhë kanë qenë 387 raste, pra ka ngritje të rasteve dhe intervenimeve prej 52%. Sipas strukturës së zjarreve kemi 28 rate të djegieve të objekteve ndërtimore, shtëpi banimi dhe

objekte ndihmëse, 47 raste të djegies së pyjeve, 294 raste të djegies së hamulloreve fushave dhe kullosave dhe 57 raste tjera është intervenuar në mbeturina, aksidente të komunikacionit rrugor, intervenime teknike dhe shërbime të ndryshme. Në kohën e fundit kemi pas mjaft vërshime ku kemi intervenuar në 54 raste sa kemi pas raste edhe të evakuimit të banorëve nga zonat ku kanë qenë të përmbytura nga uji. Sipërfaqet e pyjeve të pësuar nga zjarri janë afër 15 ha, ndërsa fusha janë afër 300 ha. Thuajse të gjitha zjarret po shkaktohen nga vet faktori njeri dhe shumica kualifikohen si zjarr vënie të qëllimshme. Pjesa më e madhe e zjarreve kanë për protagonist bujqit, barinjtë dhe keqbërësit e pyjeve të cilët kanë për traditë të përdorin këtë teknikë të rrezikshme për të rigjeneruar kullosat. Teknika e djegieve të pyjeve nga keqbërësit ka për qëllim fshehjen e gjurmëve të dëmeve, por ka edhe nga ta që i vënë zjarrin pyllit sepse kanë konflikte individuale, por në asnjë rast zjarret nuk janë shkaktuar nga temperaturat e lara. Ajo që ka rëndësi është edhe fakti se shumë raste të zjarr vënies mbesin pa autorë dhe jemi të vetëdijshëm për numrin e vogël të policëve në Stacionin Policor, por meqë këto raste gjithherë adresohen te Stacioni i Policisë atëherë kërkojmë që të ndjekim sa më shumë autorët e zjarr vënies, sepse zjarrfikësit nuk e kanë mundësinë për ndjekjen e këtyre autorëve. Ngritja e shkallës së senzibilizimit të qytetarëve për të parandaluar rënien e zjarreve, ngritja e nivelit të vrotimit nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, organizimi i bashkërenduar i reagimit i të gjitha strukturave përgjegjëse për fikjen e zjarreve kur ato ndodhin dhe ndëshkimi pa hezitim ndaj atyre që shkaktojnë zjarreve, janë disa prej masave që duhet të ndërmerren në të ardhmen, masa që zjarret të parandalohen duhet në të ardhmen të shpërndahen vazhdimisht udhëzime e fletushka në mënyrë që qytetarët të vetëdijesohen për ruajtjen e natyrës, qoftë pyjet, fushat etj. Po e përsëris se numri pamjaftueshëm i zjarrfikësve sigurisht paraqet sfidë për menaxhim efektiv të zjarreve. Krahas informatës kam edhe pjesën në formë tabelore ku përshkruhet në secilin muaj se sa intervenime janë bërë dhe lokacionet e intervenimeve, e që nuk po i lexojë me radhë pasi që ka shumë por çka do që juve u intereson unë mund të përgjigjem.

z. Avni Fetahu, theksoi, e hap debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

znj. Valbona Blakçori, theksoi, duke iu referuar parafolësit zjarret sidomos kohën e fundit kanë qenë jashtëzakonisht shqetësuese, megjithatë ne kemi ndërmarr veprime edhe hetimore, por nuk po i referohem statistakisht për numrin e tyre, por po i referohem muajit shtator dhe fillimit të muajit tetor. Me të vërtetë kemi pas shumë raste kur Njësia e Zjarrfikësve ka intervenua, por në aspektin e sigurisë ka qenë edhe Policia prezentë. Vetëm vikendin e kaluar diku kemi pas 20 vatra të zjarreve, prej tyre janë hap 5 raste dhe janë arrestuar 4 persona të cilët do të ndiqen penalisht, por ka pas persona që i kemi sanksionuar për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë publike apo ndotjes së ambientit. Zjarr vëniet bien në domenin e përgjegjësisë së Policisë, dhe sipas vlerësimeve rezulton që të gjitha këto zjarre anë të qëllimshme sepse të gjitha zjarret janë shkaktuar pasi kanë ra temperaturat. Ne kemi bërë fushata vetëdijësuese, kemi shpërndarë edhe disa fletushka vetëdijësuese për qytetarët që të mos ndezin zjarret mirëpo kjo ndodhë për shkak tani në kohë të vjeshtës qytetarët bëjnë pastrimin e arave dhe mbetjet i djegin. Këto zjarre nuk bëjnë vetëm ndotjen e ambientit por paraqesin edhe rrezik për jetën e qytetarëve dhe për pronën, sepse ne kemi pas raste edhe të djegies së shtëpive si pasojë e një zjarri krejt të vogël. Kemi bërë fushata, kemi biseduar me ta, kemi dal pothuajse në secilin fshat dhe kemi shpërndarë informata edhe për masat të cilat do të ndërmerren, mirëpo kjo prapë se prapë është duke vazhduar. Ne kemi angazhuar 5 njësi sektoriale që i kemi dhe të gjithë kanë biseduar me përfaqësues të fshatrave lidhur me ndezjen e zjarreve. Mandej ne kemi biseduar edhe me anëtarë të KLSP-ve që edhe ata ta ushtrojnë ndikimin e tyre. E përsëris

Policia është duke ndërmarrë veprime hetimore karshi të gjithë atyre që po i shkaktojnë këto zjarre. Ne madje kemi sanksionuar persona edhe që nuk i kemi hasur në vendin e zjarrit, mirëpo është logjike që askush nuk vjen për ta pastruar arën dhe në fund me i djeg mbetjet. Ne kemi sanksionuar persona në procedurë për kundërvajtje ku dënimi parashihet prej 50-500 €, por momentalisht nuk e kam numrin e saktë se sa persona e kemi sanksionuar.

z. Alban Zeka, theksoi desha të lidhem me parafolësit. Edhe ne si Drejtori e Inspeksionit kemi qenë në vazhdimësi në lëvizje në këtë periudhën e fundit, madje disa herë kemi kontaktuar me zjarrfikësit dhe Policinë për vatrat e zjarrit që kemi hasur. Kemi pas një rast në fshatin Orllan ku është djegur një stallë por jo e etazhitetit të madh. Sot në mëngjes pata një ankesë nga një palë të cilit i ishin djegë disa vetura por jo që kanë qenë të gjitha funksionale. Sipas ankesës flakën ia kishte dhënë një grua gjoja për shkak të problemeve të natyrës mendore. Dëmi ishte në vlerë afërsisht prej 15,000-20,000 €. Dikush e kishte orientuar te Drejtoria e Inspeksioni gjoja se ne mund t'i bëjmë zgjidhje. Unë i tregova për natyrën e punës që ne e kemi si Drejtori dhe çka ne mund të ndihmojmë, kështu që mbet të shkohet në instanca tjera. Duke marr parasysh se Komuna jonë ka territorin më të madh prej komunave në nivel Kosove është pamundur të mbulojmë tërë territorin me 2-3 inspektorë që i kemi pas në kujdestari, por nuk është se kemi qëndruar duar kryq në këtë drejtim. Sido që të jetë uroj që dëmet të jenë sa më të vogla ndërsa shkaktarët e këtyre zjarreve të ndëshkohen dhe të marrin dënimin e merituar.

z. Shemsi Jashari, theksoi, dëgjova me vëmendje raportimin e Drejtorit, ke një konstatim i gjendjes si është. Pra sipas statistikave numri i rasteve ishte shumë më shumë se sa që qytetarët kanë njohuri, por si statistika janë shqetësuese, dmth jemi duke folur për diçka që po jemi në dijeni se ku është fajti, ku është mungesa e edukimit të atyre që sillen në kundërshtim me rregullat dhe ndezin zjarret, mirëpo nuk dëgjuam diçka se çka ka bërë komuna në këtë periudhë. Kompetencat janë të qarta dhe ato i ka policia. Togerja na njoftoi për veprimet që i ka ndërmarr Policia, por si institucion si komunë, çka keni bërë për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Në fund konstatimi i gjendjes si jo e mirë dhe ankesa që nuk është puna mirë i takon qytetarit. Ekzekutivi i ka mekanizmat që duhet me ndryshuar këtë gjendje, cila është strategjia për dalje nga kjo gjendje. Jemi në dijeni me problemin e kompetencave me zjarrfikës, por kjo gjendje po zgjat dhe pasojat po i bart Komuna e Podujevës. Nuk mbahet ky territor, këta banorë me një numër kaq të vogël të zjarrfikësve, e që në fakt ky numër i zjarrfikësve i plotëson kushtet veç për shoferë të atyre automjeteve apo shërbimit, e jo për të intervenuar. U përmend më herët se shërbimi i zjarrfikësve nuk ka shkallë për ngjitje në objekte të larta. Ndoshta është dashur të mendohet për identifikimin e kompanive me vinça të lartë që në raste të emergjencave me i kontaktua, me shfrytëzuar një pajisje private për shpëtim eventuale të jetës së ndokujt që mbetet i mbyllur në objekte të larta, pra në objekte ku nuk mund të kenë qasje zjarrfikësit. Sipas raportimit në situatat e zjarrvënies po identifikohen bujqit ata që edhe janë shkaktar të zjarreve, e këta bujq po subvencionohen nga Komuna e Podujevës dhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Është dashur të mendohet si të paralajmërohen ata bujq apo fermerë, se nuk mund të jenë përfitues të subvencioneve e në anën tjetër shkaktojnë dëme përmes djegieve. Këtu duhet bashkëpunuar edhe me disa shoqata të bujqve, paralajmëruar se nëse jeni shkaktar i zjarrvënies nuk do të jesh përfitues i subvencioneve, sepse nuk mund të jetë edhe përfitues edhe dëmtues në të njëjtën kohë. Nuk jam në dijeni se sa gjopa janë shqiptuar ndaj atyre që kanë shkakuar zjarret por po rezulton se janë pak. Unë e kuptoj ndjeshmërinë e bujqve, por pa shqiptim

të masave adekuat po shihet se gjendja nuk po përmirësohet. Paralelisht me vetëdijesimin duhet ndërmarrë edhe masat ndëshkuese, por në këtë punë mendoj se Komuna e ka përgjegjësinë, në këtë rast Drejtoria e Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural për identifikimin e pronave që janë djegur, së bashku me Agjencinë për zjarifikësit, për të përpiluar një listë të peronave që kanë shkaktuar zjarret duke i paralajmëruar se nuk mund të jenë në të njëjtën kohë edhe përfitues edhe dëmtues. Ajo që jam duke kërkuar është që si komunë për të siguruar gjendjen reale në terren që ka dhe për të shikuar për hapat që duhet ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes. Togerja e përmendi se kemi kontaktuar me përfaqësues të fshatrave, është mirë ky veprim por ata përfaqësues të fshatrave që keni kontaktuar nuk janë legjitim, nuk përfaqësojnë bash asgjë. Nuk janë të zgjedhur dhe nuk i dëgjon askush fare. Është filluar si proces zgjedhja e Këshillave Lokale që ka përfunduar dhe është dashur të vazhdoj ai proces, sepse janë mbajtur 4-5 takime dhe aty ka mbetur. Ata përfaqësues dhe kryesi të Këshillave Lokale është dashur të përcjellin këtë mesazh, këtë shqetësim, dmth nuk janë aktiv, ndërsa Komuna ende nuk ka rifilluar këtë proces pas pauzës. KLSP nuk janë aktive. Komuna e ka këtë përgjegjësi, me i plotësua KLSP, Këshillat Lokale, me kontaktuar bujqit dhe shoqatat e bujqve dhe këtë mesazh ta shpërndajë, si dhe në fund çështja e ndëshkimeve duhet qenë më serioze. Si përfundim mendoj se si komunë të mendoj për një strategji me veprime konkrete për qasje të këtij problemi. E kemi problemin e njëjtë edhe me hedhje të mbeturinave inerte që janë, pastaj me therje të kafshëve duke i hedhur mbetjet gjithkrah, ndërsa me qentë endacak po besoj se kemi për të pasur një informatë nga Drejtori. Pra me një qasje pak më ndryshe apo me një strategji për të reduktuar këtë nivel të dëmit që është duke u shkaktuar.

z. Alban Zeka, theksoi, lidhur me diskutimin e parafolësit ne si Drejtori e Inspeksionit kemi shqiptuar gjoba që numri sillet rreth 50, po ashtu edhe me deponitë ilegale Inspeksioni ka ndërmarrë masa për largimin e tyre. Drejtori në vazhdim përmendi disa lokacione ku ka ndërmarr masa dhe ka detyruar për largimin e tyre. Theksoi, gjithashtu jemi duke përcjell edhe funksionimin e tregut të kafshëve edhe pse është një numër i vogël i qytetarëve që frekuentojnë gjatë ditës së shtunë në treg. Edhe ata që janë duke bërë tregtimin e shpezëve, jemi duke përcjell edhe këtë kategori dhe jemi duke i detyruar ti pastrojnë dhe largojnë mbetjet. Kështu që nuk është se nuk po veprojmë në këtë drejtim.

z. Shemsi Jashari, shtroi pyetje, a ka deponi për mbetjet nga therjet e kafshëve.

z. Alban Zeka, theksoi, lidhur me pyetjen e parafolësit nuk kam njohuri për ndonjë deponi të tillë.

z. Shemsi Jashari, theksoi, dmth nuk ka, këtu është problemi se ju si institucion duhet të caktoni një deponi të këtyre mbetjeve, kushtet se si duhet vepruar me ato mbetje si dhe masat ligjore dhe shqiptimin e gjobave për shkak të hedhjeve të mbetjeve. Kjo është një çështje që duhet bërë zgjidhje, por nuk ka deponi për hedhje të mbetjeve nga therjet e kafshëve, nuk ka lokacion ku mund të theren përveç thertoreve të licencuara. Jam në dijeni se për shkak të traditave gjatë festave theren kafshët. Problemi këtu qëndron se nuk ka qasje për të zgjidhur këtë problem. Unë ju sugjeroj të caktoni një lokacion, caktoni kushtet se si duhet vepruar kur ndokush ther ndonjë kafshë dhe në rastet kur haset në persona që veprojnë në kundërshtim me ato rregulla atëherë duhet marr masa ligjore të dënimeve, por si mund ta dënosh dikë kur si autoritet nuk keni caktuar lokacion ku mund të bëhet therja, nuk mund t'i thuash mos prej kurban për shkak të traditave. Therjet bëhen në territorin e Komunës dhe lokacionet cakton Komuna.

Nënvizoi, nuk është në rregull me u varros mbet e kafshëve pas therjes. Ata që për shkaqe të besimit e bëjnë therjen e kurbanit dhe dikush i thotë se duhet varrosur këto mbetje në aspektin fetar, nënkupton që duhet hedhur në sipërfaqe, pastaj këtu kemi edhe një dukuri tjetër të aktivizimit të qenve endacak, ku cenohet edhe siguria e atyre që qarkullojnë në atë pjesë. Dua të them se një komunikim i akterëve që preken në këtë fushë mendoj që është i domosdoshëm. E përsëris Komuna të caktoj një lokacion dhe përmes një rregulloreje komunale të përcaktoheshin kushtet dhe kriteret e therjes së kafshëve. Me një fushatë vetëdijësuese, ku prapë te therjet rolin kryesor e ka Bashkësia Islame me iu tregua qytetarëve se edhe nuk është shumë sevap kur ther kafshë dhe bën dëm tjetër. Pra dua të them se është pak më gjerë, më kompleks ky problem. I njëjti problem është edhe me mbetjet inerte, edhe pse për këto inerte nëse nuk gaboj është një lokacion i caktuar. Fola për një çasje që Komuna duhet ta bëj.

z. Bahri Selimi, theksoi, kjo që u theksua nga parafolësi është e rregulluar me aktin komunal për menaxhimin e mbeturinave. Mendoj se nuk është problem i madh me therjet që bahen, por problem shqetësues është atëherë kur po ka raste të ngordhjes së kafshëve dhe po i hedhin. Ne kemi kontratë të lidhur me kompaninë Regjionale "Pastrimi" e cila bën varrosjen e shtazëve të ngordhura kurdo që paraqitet nevoja, qoftë edhe në ekonomitë familjare.

z. Shemsi Jashari, shtroi pyetje, sa mund të jetë numri i shtazëve të ngordhura e të varrosura.

z. Bahri Selimi, theksoi, tani për tani se nuk kam të dhëna statistikore për numrin e kafshëve të varrosura nga ndërmarrja "Pastrimi", por ndërmarrja përgjigjet në secilin rast të ngordhjes së shtazëve të paraqitura sipas kërkesave, ndërsa Komuna i bënë pagesën ndërmarrjes për shërbimin e bërë ndaj qytetarit. Edhe pse kemi kaluar në një temë krejt tjetër dua të theksoj se Podujeva ka nevojë ta mbyllë atë deponi fare sepse edhe ashtu nuk plotëson kushtet dhe paraqet rrezik dhe ka nevojë të bëjë deponi të re, duhet bërë zgjidhje me një deponi në nivel regjional, por kjo është temë e gjerë që jemi duke punuar shumë gjatë, pra nuk dua ta zgjasë sepse edhe ashtu është një temë tjetër dhe do të kemi rast herëve tjera.

z. Avni Fetahu, theksoi, nëse nuk keni diçka tjetër rreth kësaj pike kalojmë në pikën e radhës.

5. Informatë për sigurinë në komunikacion dhe trajtimi i qenve endacak

z. Avni Fetahu, theksoi, Policia veç se dha informatën për komunikacion përmes raportit të paraqitur, ndërsa për pjesën tjetër të kësaj pike fillimisht fjalën e ka Drejtori Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, theksoi, po paraqes një informatë në bazë të një kontrate që kemi lidhur për trajtimin e qenve endacak e që është përmbyll si kontratës javën që shkoi. Në përputhje me kontratën kemi përgatitur këtë raport përfundimtar. Trajtimi i qenve bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës që i referohet mbrojtjes së kafshëve nga i cili edhe ne si autoritet komunal detyrohemi ti përmbahemi. Qëllimi kryesor sipas këtij ligji është ruajtja e shëndetit të qenve. Projekti synon parandalimin e shumimit të tyre përmes formave të sterilizimit, pastrimit etj. si dhe ndalimin e përhapjes së sëmundjeve përmes vaksionimit dhe në raste të veçanta ku është konstatuar nga veterinari për përhapjen e ndonjë sëmundjeje është eutanazu, si dhe të promovojë praktikat humane dhe të përgjegjshme për menaxhimin e tyre. Në disa raste kur qentë janë me sëmundje të

vlerësuar të pashërueshme eutanazia është një opion i vlerësuar për të shmangur vuajtjet e tyre si dhe mos përhapjen e sëmundjeve të tjerët. Nëpërmes edukimit të komunitetit dhe senzibilizimit të opinionit dhe bashkëpunimit me organizatat e tjera në mbrojtjen e kafshëve synojmë të rrisim ndërgjegjësimin dhe përkushtimin për një mirëqenie më të mirë dhe jetë më të shëndetshme të qenve endacak. Aktivitetet të cilat i bëjmë ne si komunë për përmbyllje të kësaj kontrate janë kontrollet në terren, e në këtë rast me Policinë kemi shumë kontakte në terren, sepse qytetarët e parë kur rrezikohen adresën e parë e kanë Stacionin Policor, ndërsa Policia na informon ne dhe ne nëse kemi kontratë të hapur intervenojmë por nganjëherë po ndodhë që nuk kemi kontratë sepse mjetet buxhetore janë të përcaktuara dhe nuk po kemi mundësi ti kalojmë ato në raport me kërkesat e shumta prej qytetarëve. Pas kontrolleve në terren si aktivitet i dytë është zënia e qenve endacak, vizita në terren gjatë trajtimit që e bën komisioni sepse operatori ekonomik është privat dhe ai mund të përdorë në forma të ndryshe për mos zbatim të kontratës apo sikurse ai dëshiron, mirëpo një komision i cili formohet krahas menaxherit dhe mbikëqyrësit të kontratës është i obliguar që çdo trajtim të këtyre qenve ta përcjell në vendin ku i bëhet trajtimi, pra përcjell komplet trajtimin e qenve dhe aktiviteti i fundit është lëshimi i qenve në vendin e zënies, pra parashihet si obligim për lëshimin e qenve aty ku është zënë. Ne e kemi parasysh se frikën e qytetarëve e të fëmijëve në veçanti nuk mund ta largojmë duke e trajtuar një qen endacak, sepse edhe pas trajtimit dhe lëshimit e qenit në vendin e zënies sikurse jemi të obliguar me ligj nuk e kemi larguar frikën, ajo mbetet e njëjta, mirëpo krejt çka po mundohemi të bëjmë është që përmes sterilizimit të ndalim përhapjen apo rritjen dhe zhvillimin e tyre. Në kuadër të kësaj kontrate ne kemi arritur të trajtojmë 230 qen endacak, ndërsa 6 prej tyre kanë përfunduar me eutanazi, vlen të theksohet se 2 prej këtyre 6 qenve kanë sulmuar nxënësit nëpër shkolla, pra kanë qenë të tërbuar. Kjo informatë rreth kontratës ishte në pika të shkurtra. Ne si autoritet komunal çdo vit fiskal lidhim kontrata të tilla për trajtim të qenve endacak edhe pse nuk kemi buxhet të mjaftueshëm për trajtimin e tyre. Kontrata sikurse e theksova është përmbyllur dhe tani më deri në janar të vitit të ardhshëm, kështu që tani nuk kemi kontratë por duhet gjetur një formë për parandalimin e rrezikut nga qentë për nxënësit dhe qytetarët.

z. Avni Fetahu, theksoi, e hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

6. Të ndryshme

z. Avni Fetahu, theksoi mund ta merrni fjalën nëse dikush ka diçka për të theksuar në këtë pikë të rendit të ditës. Nëse jo unë e ndiej si obligim ti përgjigjem **z. Shemsi Jashari**, për çështjen që u diskutua në pikën e dytë të rendit të ditës, është fjala për transmetimin e mbledhjeve të KKSB. Shpresoj se Zyra ligjore duhet të gjej një formë dhe me kthye një përgjigje, përndryshe unë jam interesuar dhe kam vërejtur se komunat tjera nuk i transmetojnë mbledhjet, e as niveli shtetëror jo duke marrë parasysh natyrën, specifikat, diskutimet, frikën që mund të paraqiten për ndonjë rast të caktuar. Kjo nuk mendoj se është me ndonjë tendencë diçka por nuk është praktikë që kemi parë në komunat tjera.

z. Shemsi Jashari, theksoi se krejt çka nuk është e ndaluar është e lejuar, por sido që të jetë kam përshtypjen se interesimi nuk është për të transmetuar mbledhjet, është Agjencia për Informim dhe Privatësi, i drejtohem dhe marrim përgjigje, e po ashtu edhe Zyra Ligjore s'po e shoh se është shumë e interesuar për të gjetur përgjigje për këtë punë. Kërkesë tjetër është që materialin i cili ka për tu diskutuar në mbledhje është mirë të na dërgohet, që të jemi të përgatitur lidhur me materialin më herët dhe të kuptojmë më drejt për çka jemi duke folur. Ne i dëgjuam të dy raportet që i paraqiti Drejtori që janë me

shkrim, që kanë shifra por që ne nuk i kemi, duhet thjesht vetëm të dëgjojmë. Kur jemi të përgatitur edhe koha e diskutimit është më e shkurtër dhe më e drejtpërdrejtë.

z. Avni Fetahu e përmbylli takimin, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. prot.02-060/04-0077419/23
Podujevë, datë: 20.10. 2023

